**URDHËR**
**Nr.177/2, datë 18.3.2020**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 177/1 DATË 16.3.2020 "PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES NË ZONAT URBANE"**

Në mbështetje të nenit 7, pika 4, germat "d" të ligjit nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", sipas udhëzmeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 177/1, datë 16.3.2020 "Për kufizimin e lëvizjes në zonat urbane, bëhen këto ndryshime si vijon:

1. Pika 1 ndryshon si vijon:

"1. Kufizimin e lëvizjes së këmbësorëve në zonat urbane, vetëm në fashat orare 06-10:00 dhe 16:00-18:00 dhe të pashoqëruar me personat të tjerë në krah".

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 si vijon:

"1/1 Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 bëjnë personat e pajisur me autorizim nga organet kompetente dhe rastet e një emergjence shëndetësore apo shoqëruesit për të sëmurët që marrin shërbim në spital".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
**Ogerta Manastirliu**